

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaBond®-52 Parquet

ADEZIV TIKSOTROPIK DHE ELASTIK PËR DYSHEMETË PREJ DRURI PËR PËRDORIM ME PAJISJE OSE APLIKIM NË FORMË KORDONI



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaBond®-52 Parquet është adeziv me 1 përbërës dhe pa tretës për dyshemetë prej druri me ngjitje fillestare të mirë dhe rrjedhë të ulët varjeje.

PËRDORIMET

SikaBond®-52 Parquet është krijuar për ngjitje të plotë të sipërfaqes me pajisjen SikaBond® Dispenser:

- Dysheme druri solide dhe inxhinierike, parket mozaik, parket industrial, parket laminat dhe sistem dyshemeje me pllaka zdrukthi dhe nëndysheme.

SikaBond®-52 Parquet është krijuar për përdorim me sistemin Sika® AcouBond® dhe aplikim në formë kordoni:

- Pllaka druri masiv, dru inxhinierik me 3 fletë, sistem dyshemeje me pllaka zdrukthi dhe nëndysheme.
- SikaBond®-52 Parquet është krijuar posaçërisht për përdorim me drurin sfidues.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Adezivi mund të smerilizohet
- Dyshemetë mund të smerilizohen pas 12 orësh
- Veti amortizimi elastik të zhurmave të hapave
- I përshtatshëm për ngjitje direkt mbi pllakat e vjetra qeramike
- I përshtatshëm për përdorim me sistemet e ngrohjes nën dysheme
- Çlirime shumë të ulëta
- Redukton transferimin e tensionit midis dyshemesë së drurit dhe nënshtresës

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- EMICODE EC1^{PLUS} R
- LEED® EQc 4.1
- SCAQMD, Rregulli 1168
- BAAQMD, Rreg. 8, Rregulli 51

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	poliuretan i teknologjisë <i>i-Cure</i>
Ambalazhi	sallam 600 ml / 790 g, 20 sallame/ kuti
Ngjyra	Kafe parketi
Jetëgjatësia	SikaBond®-52 Parquet ka jetëgjatësi prej 12 muajsh nga data e prodhimit, nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur dhe nëse plotësohen kushtet e magazinimit.
Kushtet e magazinimit	SikaBond®-52 Parquet duhet të ruhet në kushte të thata, i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe në temperatura midis +5°C dhe +25°C.
Dendësia	~ 1.30 kg/l (ISO 1183-1)

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~ 35 (pas 28 ditësh)	(ISO 868)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~ 1.4 N/mm ²	(ISO 37)
Zgjatimi deri në thyerje	~ 600%	(ISO 37)
Rezistenca ndaj prerjes	~ 1.1 N/mm ² , trashësi adezivi 1 mm	(ISO 17178)
Temperatura e funksionimit	+5 °C deri në +40 °C	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	<p>Sistemi Sika® AcouBond®:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ ~ 400–500 ml/m² për SikaLayer®-03 dhe ~ 500–600 ml/m² për SikaLayer®-05. Duhet mbushur të gjitha hapësirat. Përdorni majë trekëndore me hapje 8 x 10 mm. <p>Ngjitje e plotë e sipërfaqes me SikaBond® Dispenser-1800 /-3600 /-5400:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Për ngjitje të plotë të sipërfaqes me SikaBond® Dispenser ju lutemi referohuni tek Method Statements të serive SikaBond® Dispenser. <p>Aplikim në formë kordonit:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ ~ 44 ml për metër linear konsumon 250–500 g/m², në varësi të hapësirës midis kordonave (pllaka druri solid, dru inxhinierik me tri fletë, pllaka zdrukthi). <p>Për nënshtresat e lyera me prajmerin Sika® Primer MB dhe/ose Sika® Primer MR Fast, konsumimi i SikaBond®-52 Parquet mund të reduktohet.</p>
Rrjedha e varjes	<p>SikaBond®-52 Parquet lë shenja të qëndrueshme gjatë aplikimit me mallë krëhër.</p> <p>SikaBond®-52 Parquet aplikohet lehtësisht me pistoleta ose pajisjet SikaBond® Dispenser.</p>
Temperatura e mjedisit	+15 °C deri në +35 °C
Lagështia relative e ajrit	40% deri në 70%
Temperatura e nënshtresës	Gjatë shtrimit dhe derisa SikaBond®-52 Parquet të jetë tharë plotësisht, temperaturat e nënshtresës dhe ambientit duhet të jenë midis +15°C dhe +35°C pa dhe midis +20°C dhe +35°C me ngrohje nën dysheme.
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	<p>Përmbajtja e lejueshme e lagështisë së nënshtresës për përdorim pa ngrohje nën dysheme:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ 2.5% përmbajtje lagështie për llaçet e çimentos për dyshemetë.▪ 0.5% përmbajtje lagështie për llaçe anhidriti për dyshemetë.▪ 3–12% përmbajtje lagështie për dysheme magnezi (në varësi të përmbajtjes organike). <p>Përmbajtja e lejueshme e lagështisë së nënshtresës për përdorim me ngrohje nën dysheme:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ 1.8% përmbajtje lagështie për llaçet e çimentos për dyshemetë.▪ 0.3% përmbajtje lagështie për llaçe anhidriti për dyshemetë.▪ 3–12% përmbajtje lagështie për dysheme magnezi (në varësi të përmbajtjes organike). <p>Shënim: Për të gjitha përmbajtjet e lagështisë, cilësinë e nënshtresave dhe sipërfaqeve, ndiqni gjithnjë udhëzimet e prodhuesit të dyshemesë prej druri.</p>
Ritmi i maturimit	3.5 mm/ ~ 24 orë (23 °C / 50% lagështi relative)
Koha e krijimit të kores / Koha e shtrimit	~ 60 minuta (23 °C / 50% lagështi relative)

UDHËZIME APLIKIMI

Për aplikimin e SikaBond®-52 Parquet vlejné të gjitha udhëzimet standarde të ndërtimit.
Për informacione të mëtejshme, ju lutemi referohuni

tek Method Statement "Ngjitje të gjithë sipërfaqes"
dhe "Pajisja për aplikimin e SikaBond®".

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

- Nënshtrësja duhet të jetë e pastër, e thatë, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vaj, graso, pluhur dhe grimca të lira. Boja, korja e çimentos dhe kontaminuesit e tjerë duhet të hiqen.
- Dyshemetë prej betoni dhe/ose llaçi çimentoje duhet të jenë të qëndrueshme dhe të pastruara me fshesë thithëse industriale.
- Llaçet e anhidritit, përfshirë dhe llaçet e rrjedhshëm të anhidritit duhet të jenë të qëndrueshëm dhe të pastruar me fshesë thithëse industriale përpara se të fillojë ngjitja me adezivin.
- Mastiku i asfaltit i spërkatur duhet lyer me prajmerin Sika® Primer MR Fast ose Sika® Primer MB. Për udhëzime përdorimi, ju lutemi referohuni tek skeda teknike.
- Pllakave qeramike me glazurë dhe atyre të vjetra ekzistuese qeramike duhet t'u hiqet yndyra dhe të pastrohen me Sika® Aktivator-205, ose sipërfaqet me pllaka duhet të jenë të qëndrueshme dhe më pas të pastrohen plotësisht me fshesë thithëse industriale.
- Pllakat e drurit dhe/ose gipsit (p.sh. pllaka zdrukthi, kompesata) duhet të ngjiten dhe/ose vidhosen tek nënstruktura në mënyrë që të fiksohen mbi nënshtrësë. Për dyshemetë lundruese të thata, kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.
- Nënshtrësja të tjera: kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik për këshilla dhe asistencë.
- SikaBond®-52 Parquet mund të përdoret pa prajmer mbi dyshemetë me bazë çimentoje, dysheme anhidriti, pllaka zdrukthi, beton dhe pllaka qeramike.
- Për mastikun e asfaltit të spërkatur, dyshemetë me bazë çimentoje me përmbajtje të lartë lagështie dhe përdorim mbi mbetjet e vjetra të adezivëve apo mbi nënshtrësja të dobëta përdorni Sika® Primer MB. Për udhëzime të detajuara kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Sistemi Sika® AcouBond®:

- Për udhëzime të detajuara aplikimi referohuni tek skeda teknike e sistemit Sika® AcouBond®, ose kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.

Ngjitje e plotë e sipërfaqes me SikaBond® Dispenser:

- SikaBond®-52 Parquet aplikohet mbi nënshtrësën e përgatitur direkt nga pajisja SikaBond® Dispenser. Ngjeshni fort copat e drurit mbi adeziv në mënyrë që pjesa e pasme e drurit të jetë mbuluar plotësisht me adezivin. Pjesët mund të bashkohen duke përdorur çekiç dhe tako. Shumë lloje dyshemesh druri duhet të adaptohen në pozicionin e tyre duke i ngjeshur nga sipër. Duhet të ruhet një distancë prej 10–15 mm nga muri tek dyshemeja e drurit. Për udhëzime të detajuara aplikimi referohuni tek skeda teknike e pajisjeve SikaBond® Dispenser, ose kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.

Aplikim në formë kordon:

- Pas vendosjes së sallamit tek pistoletë, nxirrni një "kordon" adezivi me formë trekëndore me lartësi 20mm dhe gjerësi 8mm (në varësi të llojit të dyshemesë prej druri) mbi nëndyshemenë e

përgatitur. Distanca midis kordonave nuk duhet të kalojë 150 mm. Ngjeshni copat e drurit tek adezivi (në këndin e duhur për nga kordonat e ngjitesit). Pjesët mund të bashkohen duke përdorur çekiç dhe tako. Duhet të ruhet distanca e kërkuar nga muri tek dyshemeja e drurit, e cila përcaktohet tek udhëzimet e shtrimit nga prodhuesi i dyshemesë prej druri. Dyshemeja pranon qarkullim dhe/ose smerilizim 24 deri në 48 orë pas instalimit (23 °C / 50% lagështi relative deri në 1 mm trashësi adezivi në varësi të kushteve të mjedisit dhe trashësisë së shtrësës së adezivit).

Adezivi i freskët dhe i patharë mbi sipërfaqen e dyshemesë prej druri duhet të hiqet menjëherë me një copë të pastër dhe nëse nevojitet të pastrohet gjithashtu me Sika® Remover-208 ose Sika® TopClean-T. Testoni gjithnjë sipërfaqet e dyshemesë prej druri për kompatibilitet me Sika® Cleaner-208 përpara përdorimit.

Ndiqui udhëzimet e prodhuesit të dyshemesë prej druri.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Remover-208 dhe/ose Sika® TopClean T. Pas tharjes, materiali i mbetur mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

- Fleta e të dhënave të sigurisë
- Tabela e trajtimit paraprak për izolimin dhe ngjitjen
- Method Statement "Ngjitje e të gjithë sipërfaqes"
- Method Statement "Pajisja për aplikimin e SikaBond®"

KUFIZIME

- SikaBond®-52 Parquet duhet të përdoret vetëm nga aplikues profesionistë dyshemesh druri me përvojë.
- Për punueshmëri të mirë, temperatura e adezivit duhet të jetë $\geq +15$ °C.
- Për tharjen e duhur të adezivit, nevojitet lagështi e mjaftueshme ambienti.
- Nevojitet një testim paraprak i ndërkapjes përpara aplikimit mbi pllakat me glazurë.
- Për sistemin Sika® AcouBond, metodën e aplikimit në formë kordoni dhe për dyshemetë me bashkime të sakta femër-mashkull, vlejnjë kufizimet e mëposhtme:
- Përmasa min. e dërrasës: gjatësi 300 mm (mbi 3 kordona ngjitesit), gjerësi 50 mm, trashësi 12 mm
- Përmasa max. e dërrasës: trashësi 28 mm
- Përpara instalimit të dyshemeve prej druri në zona të paizoluara, si bazamentet apo zona të tjera pa membranë kundër lagështisë, duhet aplikuar Sikafloor® EpoCem dhe të izolohet me Sika® Primer MB për kontroll të lagështisë. Për udhëzime të detajuara, kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.
- Për përdorim me llojet kimikisht të trajtuara të dyshemeve prej druri (p.sh. ato të prodhuara ose të trajtuara me amoniak, bojë druri, konservant druri) dhe dru me përmbajtje vaji relativisht të lartë, SikaBond®-52 Parquet mund të përdoret vetëm me

miratimin me shkrim nga departamenti ynë i shërbimit teknik.

- Të mos përdoret mbi polietilen (PE), polipropilen (PP), politetrafluoroetilen (PTFE / Teflon), dhe materiale të tjera të ngjashme sintetike të plastifikuara.
- Disa materiale të tjera prajmeri për dyshemetë mund të ndikojnë negativisht ndërkapjen e SikaBond®-52 Parquet (rekomandohen testime paraprake).
- SikaBond®-52 Parquet është krijuar si një adeziv për ngjitjen e dyshemeve prej druri. Gjatë shtrimit të dyshemeve prej druri të llojit parket pa bashkim femër-mashkull, psh. dysheme parketi mozaik, të shmanget dalja e adezivit tek fugat ndërmjet pjesëve prej druri.
- Shmangni kontaktin midis çdo lloj veshjeje izoluese të dyshemesë prej druri dhe adezivit. Megjithatë, nëse kontakti i drejtpërdrejtë me adezivin është i pashmangshëm, atëherë duhet kontrolluar dhe konfirmuar kompatibiliteti përpara përdorimit të çdo lloj veshjeje. Për informacione dhe këshilla të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.
- Mos ekspozoni SikaBond®-52 Parquet e patharë ndaj produkteve me përmbajtje alkooli pasi mund të ndikojnë në reaksionin e tharjes.
- Për informacione dhe këshilla të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaBond®-52 Parquet

Mars 2019, Botimi 01.01

020512010000000003

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaBond-52Parquet-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf